



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

Duke u mbështetur në nenin 17. Shkronjën n) dhe r) neni 40 paragrafi 40.2 shkronjën l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040. neni 40 paragrafi 2 pika 11-të e Statutit të Komunës së Klinës, dispozitat e Ligjit për procedurën e përgjithshme administrative nr. 05/L-031. Me kërkesën e parashtruar nga drejtoria për kulturë rini dhe sport. Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e II-të të rregullt të vitit 2022, të mbajtur më datë: 25.02.2022, mori këtë:

V E N D I M


Për

Ndryshim-plotësim të vendimit 01.Nr.643-119/2002 i datës 08.02.2002 për mbajtjen e festivalit folklorik "I këndojmë lirisë"

1. Miratohet kërkesa për ndryshim-plotësimin të vendimit 01.Nr.643-119/2002 i datës 08.02.2002 për mbajtjen e festivalit folklorik "I këndojmë lirisë"
2. Me këtë vendim ndryshon pika I (një) e vendimit të parë si në vijim:
3. Organizimi i festivalit folklorik "I këndojmë lirisë" do të jetë tradicional dhe do të mbahet çdo vit me datë: 6, 7 dhe 8 Qershor
4. Të gjitha punët tjera përgatitore dhe organizative rreth mbajtjes së këtij festivali do ti kryej Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport
5. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
6. Me këtë vendim njoftohet: MPL, Kryetari i Komunës, Drejtoria për KRS , Zyra për Informim dhe Arkivi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS KLINË

01Nr. 06-7072 2022
Klinë, më 09.03 2022



Kryesuesi,
Fadil GASHI